

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar: Partia e Gjelber

Blv. "Bajram Curri" P/31, shk.1, Ap.4, Tirane

Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

Bulevardi Deshmoret e Kombit, Pallati i Koncerteve

Tirane

Bazuar ne Ligjin 10019 date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise" i ndryshuar ,ne zbatim te Vendimit te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve nr.969,date 10.08.2015 , Kontrates se sherbimit nr.7670 date 23.09.2015 te lidhur me KQZ ,nga ana ime ne cilesine e Ekspertit Kontabel te Regjistruar ,si dhe kontraten shtese per percaktimin e modaliteteve te punes dhe pageses lidhur me date 15.10.2015 me Partine e Gjelber te perfaqesuar nga z.Edlir Petanaj, kemi audituar pasqyrat financiare te Partise se Gjelber ,të cilat përbehen nga bilanci kontabël i dates 31 Dhjetor 2014,pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve,pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet dhe pasqyra e flukseve të parave për vitin e mbyllur financiare ,si dhe përmbledhjen e metodave kontabël dhe shenimet shpjeguese.

Pergjegjësia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi është pergjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit. Kjo pergjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshëm të përshtatshëm mbi paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi,zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël,dhe kryerjen e cmuarjeve kontabël të asyeshme për rrethanat.

Pergjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tone. Auditimi **jone** u bë në përputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit.Keto standarte kërkojnë që Ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit duke perfshire vleresimin e rrethave per anomali ne pasqyrat financiare,qofte per shkak te mashtrimit ose gabimit.

Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut , audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te entitetit ne përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave finciare ne menyre qe te hartojte procedurate auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat por jo per

qellimin e shprehjes se opinionit per efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali ne pasqyrat financiare,qofte per shkak te mashtrimit ose gabimit.

Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut , audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te entitetit ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave finciare ne menyre qe te hartoje procedurate auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.

Auditimi , gjithashtu perfshin vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe llogjiken e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrat financiare.

Ne,besojmë që evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tone te auditimit .

Opinion

Sipas opinionit tonë ,pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Partise se Gjelber, me 31 Dhjetor 2014,të rezultatit të saj financiare dhe të flukseve të parave te saj për vitin e mbyllur financiare me 31.12.2014 në përputhje me Ligjin 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”,i ndryshuar dhe Ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Shkelzen MARGJEKA

EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR
LIC.NR.178 ,DATE 15.10.2008 .

Tirane ,me.26.10.2015